



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr Prot: 01-737/16
 Br Prot: 02
 Proi No: 20/DPK
 Datim: 24.02.2016

DATË/A:	24/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK – DPK – DPKPP – 03-03-608/16
PËR/ZA/TO:	z. Fadil MUZAQI Drejtor i Prokurimit - Komuna Vushtrisë
CC:	z. Bajram MULAKU Kryetar Komune – Komuna Vushtrisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Furnizimi me artikuj ushqimorë për shtëpinë e komunitetit në fsh. Lum Madh"

I nderuar z. MUZAQI,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: "Furnizimi me artikuj ushqimorë për shtëpinë e komunitetit në fsh. Lum Madh" me numër prokurimi: 644/16/007/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: "Furnizimi me artikuj ushqimorë për shtëpinë e komunitetit në fsh. Lum Madh" me numër prokurimi: 644/16/007/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna e Vushtrrisë keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Furnizimi me artikuj ushqimorë për shtëpinë e komunitetit në fsh. Lum Madh" me numër prokurimi: 644/16/007/221, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 08/02/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, në tabelën Specifikimet teknike të detyrueshme, në pikat: 12, 15, 24, 51, 59, 75, 83, 89, 90 dhe 91 janë kërkuar: Djathë zdenka; Eurocrem; Keks pettit beurre; Pashtetë argetë 100 gr; Mazë Halta; Shllag Hopla pa sheqer; Vegetë 1/1; Coca Cola; Fanta; dhe Margarinë Vital. Të gjithë këta artikuj të lartë përmendur, janë kërkuar me emrat e produkteve. Autoriteti kontraktues nuk duhet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

Tutje, autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik. Me caktimin e emërimit të prodhuesit për produktet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, ju si autoriteti kontraktues keni favorizuar prodhues të caktuar, duke i diskriminuar të tjerët në raport me favorizuesit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !